

VENDIM
Nr.651, datë 27.9.2006

PËR MIRATIMIN E PROJEKTKONTRATËS, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË SË PËRBASHKËT “BECHTEL INTERNATIONAL, INC.-ENKA”, PËR NDËRTIMIN, ME RITME TË PËRSHPEJTUARA, TË SEGMENTIT RRUGOR RRËSHEN-KALIMASH, TË AUTOSTRADËS DURRËS-KUKËS-MORINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të vendimit nr.481, datë 14.6.2006 “Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve të përdorë procedurën e prokurimit “Tender i hapur ndërkombëtar”, për ndërtimin, me ritme të përshpejtuara, të segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash të autostradës Durrës-Kukës-Morinë, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e projektkontratës, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe shoqërisë së përbashkët “Bechtel International, Inc.-ENKA”, për ndërtimin, me ritme të përshpejtuara të segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash, të autostradës Durrës-Kukës-Morinë.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Financave për zbatimin e detyrimeve, që rrjedhin nga ky vendim dhe nga kontrata.

3. Kërkesa për punësimin e punonjësve, e përcaktuar në shkronjën “ç” të pikës 4 të vendimit nr.262, datë 25.5.2000 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien e lejes për punë shtetasve të huaj”, në zbatim të ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 “Për të huajt” nuk është e detyrueshme në zbatimin e kësaj kontrate.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha